



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KRYETARI

Nr. 751 prot.

Përmet, më 11.03.2024

VENDIM

Nr. 104 datë 11.03.2024

**PËR
MIRATIMIN E KODIT ETIK TË BASHKISË**

Bazuar në nenin 64 pika j) të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji Nr.9131, datë 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”, Ligji Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjin Nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë,

VENDOSA:

- 1.Miratimin e Kodit Etik të Bashkisë Përmet bashkëlidhur këtij Vendimi.
- 2.Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Zyra e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Përmet, të gjitha Drejtoritë, Sektorët, Njësitë Administrative dhe Institucionet e varësisë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA**



MIRATOI
KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA

KODI ETIK I BASHKISË PËRMET

Baza ligjore:

- Ligji Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji Nr.9131, date 08.09.2003”Për Rregullat e Etikës me Administratën Publike”
- Ligji Nr.152/2013”Për nëpunësin civil”,i ndryshuar
- Ligji Nr.7961 date 12.07.1995”Kodi i Punës ne Republikën e Shqipërisë”,i ndryshuar

KREU I

PARIMET BAZE

Neni 1

Vlerat individuale morale

Te gjithë nëpunësit jane te detyruar te respektojne kushtetuten, ligjet dhe aktet e tjera nenligjore, si dhe parimet e etikes, te jene te ndershem e te paanshem, te rritin efektivitetin e punes per te gjithë strukturat e sherbimit civil dhe te forcojne besimin e mbeshtetjen e publikut ndaj tyre.

Punonjesit e bashkise duhet te eliminojne ne jetën private sjelljet qe kane ndikim negativ ne imazhin e tyre te krijuar ne shoqëri, ose qe lekundin besimin e publikut, bazuar ne nje administrate te paanshme, ligjore dhe profesionale.

Neni 2

Sjellja

Punonjesit e Bashkise duhet te sillen ne perputhje me parimet e etikes dhe brenda njohurive te tyre ti pergjigjen publikut me saktësi, qartësi dhe kulture per çdo paqartësi apo pakënaqësi qe publiku paraqet ndaj tij ose bashkise Përmet.

Neni 3

Transparenca

Punonjesit e Bashkise brenda njohurive te tyre, i bejne te ditur publikut sherbimet qe ai apo bashkia e tij kane per detyre ti japin.

Neni 4

Efektiviteti

Punonjesit e Bashkise shfrytezojne te gjitha aftësite e tyre per kryerjen e detyrave shtetërore me maksimumin e efijences dhe e perdorin kohen e punes vetem per kryerjen e këtyre detyrave.

Punonjesit e Bashkise veprimtarine e tyre e ushtrojne ne perputhje me kushtetuten, ligjet dhe aktet e nxjerra ne baze dhe per zbatimin e tyre. Punonjesit e bashkise duhet te perpiqen te shmangin ato sjellje apo veprime, te cilat krijojne pershtypjen se punonjesit po shkelin ligjin apo parimet e etikes.

Neni 6
Shmangia e konfliktit te interesave

Punonjesit e Bashkise duhet te bejne publike te gjitha investimet e tyre, interesat ne pasuri te paluajtshme dhe te ardhurat me qellim qe te parandalohet konfilkti i interesave.

Neni 7
E drejta e informimit

Çdo person ka te drejte te informohet brenda afateve te parashikuara ne kete kod per dokumentet zyrtare qe kane te bejne me veprimtarine e bashkise dhe te punonjesve te saj pervec rasteve kur me ligj eshte parashikuar ndryshe.

Neni 8
Ndalimi i mitmarrjes

Punonjesit e Bashkise nuk duhet te kerkojne dhe pranojne nga askush si shperblim per kryerjen e e detyrave te tyre ne te shkuaren, ne te tashmen, ose ne te ardhmen, para ose sende te tjera me vlere monetare.

Neni 9
Rritja e profesionalizmit

Punonjesit e Bashkise duhet te kene njohuri rreth akteve ligjore dhe nenligjore, urdheresave dhe rolet e zyrtareve te zgjedhur dhe punonjesve te tjere bashkiake si dhe te procesit te zgjedhjeve bashkiak.

Neni 10
Rritja e besimit te publikut

Punonjesit e Bashkise duhet te punojne per rritjen e besimit te publikut ne qeverisjen qendrore dhe vendore duke vene te gjitha forcat dhe aftesite e tyre ne sherbimin e tij.

Neni 11
Raportimi shkeljeve

Punonjesit e Bashkise duhet te raportojne çdo rast vjedhjeje, korrupsioni dhe shkelje te ketij kodi prane zyres se burimeve njerezore
Te drejten per te raportuar shkelejt e mesiperme e kane dhe anetaret e keshillit bashkiak dhe qytetaret.

Neni 12
Zbartimi i kodit

Kodi etik i Bashkise Përmet duhet te njihet dhe te zbatohet nga te tere punonjesit e bashkise Përmet.

KREU II
Detyra e pergjegjesite e zyrës se burimeve njerezore

Neni 13

Zyra e Burimeve Njerezore ka per detyre;
T'u beje te njohur kodin e etikes punonjesve te Bashkise Përmet;
Te kontrolloje ne menyre periodike respektimin e tij;
Te marre ankesa per shkelje te ketij kodi nga qytetaret, punonjesit e bashkise, keshilli bashkiak dhe kryetari i bashkise.

Neni 14
Pergjegjesite e Zyres se Burimeve Njerezore

Zyra e burimeve njerezore çdo 6 muaj duhet te paraqesi nje raport publik per Kryetarin e Bashkise dhe Keshillin Bashkiak per zbatimin e kodit, numrin dhe tipin e ankesave, sa çeshtje perbejne shkelje te renda, sa jane verifikuar dhe si jane zgjidhur.

KREU III
KONFLIKTI I INTERESAVE DHE SHMANGIA E TIJ

Neni 15
Raste e konfliktit te interesave

Me konflikt interesash do te kuptojme konfliktin qe mund te linde gjate kryerjes se punes zyrtare ndermjet interesit privat te nepunesve dhe interesit publik qe ata duhet te mbrojne dhe perfaqesojne.

Kemi konflikt interesash kur punonjesi i bashkise, ne punen e tij zyrtare, merr pjese ose ndikon ne procesin e vendimmarrjes per probleme qe kane efekt ne interesat financiare ose jofinanciare te:

- a. vete punonjesit;
- b. bashkeshortit ose bashkeshortes se tij;
- c. femijeve qe ai ka nen ngarkim;
- d. organizatave ose subjekteve jopublike, qofshin keto per qellime fitimi ose jofitimi, ne te cilat personat e lartepmendur mund te jene te punesuar si konsulente, pronare, anetare etj;
- e. personave, organizatave a subjekteve, me te cilat personat e lartepmendur po negociojne ose kane rrene dakort per nje punesim te ardhshem te tyre

Neni 16
Perjashtimi nga veprimtarite ne konflikt me interesat

Pertjashtimi i nepunesve te Bashkise nga veprimtarite qe jane ne konflikt me interesat e tyre behet me kerkese nga:

- a. vete punonjesi i Bashkise drejtuar Zyres se Burimeve Njerezore kur deklarone ekzistencen e konfliktit te interesit;
- b. çdo person qe ka dijeni per ekzistencen e ketij konfliktit;
- c. Zyra e Burimeve Njerezore kur ka dijeni per ekzistencen e ketij konfliktit

Neni 17
Heqja dore nga pasuria qe shkakton konflikt interesash

Nese punonjesi i Bashkise ka pasuri ose interesa te tilla qe vazhdimsia e zoterimit te tyre do te perbente nje rrezik real dhe te vazhdueshem per lindjen e konfliktit te interesave, gje qe do te sillte perjashtimin e vazhdueshem te punonjesit nga veprimtaria e tij zyrtare dhe pamundesine e tij per te punuar atehere punonjesi heq dore nga ato pasuri ose interesa. Kjo mund te behet duke i shitur ato, duke i kembyer ose duke ndryshuar perdorimin.

Neni 18
Kerkesa per te hequr dore nga pasuria

Kerkesa drejtuasr punonjesit te Bashkise per te hequr dore nga pasuria paraqitet si alternative vetem ne rastet kur konflikti i interesave do te ishte aq i madh e i vazhdueshem sa qe alternativa tjeter e vetme per ta shmangur kete konflikt do te ishte ndryshimi i vendit te punes.

Kerkesa ndaj punonjeit per te zgjedhur, brenda nje afati kohor te arsyeshem, jeren nga keto alternativa behet nga Zyra e Burimeve Njerezore.

Nese punonjesi i Bashkise mendon se eshte vene padrejtesisht para kesaj alternative, ai ka te drejte te ankohet tek kryetari i bashkise.

Neni 19
Shamngia e konfliktit te interesave ne hetimin e nje ankese

Ne rast se zyra e Burimeve Njerezore vendos se ka nje konflikt interesash ne nje hetim ankese duhet tia kaloje per verifikim Kryetarit te Bashkise.

KREU IV
DHENIA E INFORMACIONIT

Neni 20
E drejta e informimit

Çdo person ka te drejte te kerkoje informacion per dokumentet zyrtare qe kane te bejne me veprimtarine e bashkise dhe te punonjesve te saj, pa qene i deturuar te shpjegoje motivet. Çdo punonjes i bashkise eshte i detyruar te jape çdo informacion ne lidhje me nje dokument zyrtar, perveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

Neni 21
Kufizimi nga dhenia e informacionit

Nese informacioni i kerkuar per nje dokument zyrtar, kufizohet me ligj, punonjesi i Bashkise i leshon kerkuesit nje deklarate me shkrim, ne te cilen trgohen motivet e mosdhenies se informacionit dhe rregullat siaps se cilave ai mund te kerkoje ate.

Nese kufizimi eshte vetem per nje pjese te te dhenave te dokumentit zyrtar, pjesa tjeter nuk i refuzohet kerkuesit.

Neni 22
Afati per mospranimin e kerkeses

Punonjesi i Bashkise vendos per mospranimin e plote ose te pjeshem te kerkeses brenda 15 diteve nga depozitimi i saj. Ne rastin e mospranimit te kerkeses, pergjigja negative, e plote ose e pjeshme, jepet e arsetuar me shkrim nga nepunesi perkates.

Neni 23
Afati per pergjigje

Nepunesi i Bashkise ploteson kerkesen branda 40 diteve nga depozitimi i saj, me perjashtim te rasteve kur ne kete ligj parashikohet ndryshe.

Neni 24
Shtyrja e afatit

Ne rast se punonjesi i Bashkise e ka te pamundur plotesimin e kerkeses brenda afatit te parashikuar ne nenin 23, per shkak te veçantise se kerkeses ose te nevojës per tu keshilluar me nje pale te trete, atehere ai njofton me shkrim palen e interesuar, jo me vone se 7 dite nga mbarimi i afatit te meparshem, per mundesin e realizimit te pjesshem ose te plote te kerkeses per informim si dhe per arsyet apo shkaqet qe e kane sjelle ate.

Ne kete rast nepunesi i Bashkise i propozon pales se interesuar njerin nga zgjidhjet e meposhtme:

- a. caktimin e nje afati te ri, i cili fillon me mbarimin e afatit te meparshem dhe qe nuk mund te jete me shume se 10 dite pa te drejte perseritje;
- b. pershtatjen e kerkeses nga ana e personit, ne menyre te tille, qe te mund te respektohet nga ana e nepunesit te Bashkise pergjegjes afati i parashikuar ne kete kod;

Personi i interesuar zgjedh njerin nga propozimet e mersiperme. Ne rast se personi ne fjale nuk shpreh pelqimin e vet para perfundimit te aftit te pare, nepunesi i Bashkise vendos shtyerjen e afatit.

Neni 25
Ankimi

Çdo person ka te drejten e ankimit ne zyren e Burimeve Njerezore.

KREU V

NDALIMI I SHPERDORIMIT TE PRONES PUBLIKE, KOHES SE PUNES DHE POSTIT

Neni 26
Ndalimi i shperdorimit te prones publike

Nepunesit mbrojne dhe ruajne pronen publike. Ata direkt ose indirekt nuk duhet te perdorin ose te lejojner te perdoret prona qe shteti zoteron ose ka ne perdorim per asnje qellim tjeter, perveçse per kryerjen e veprimtarive te mioratuara zyrtarisht.

Neni 27
Ndalimi i shperdorimit te kohes se punes

Nepunesit e Bashkise e perdorin kohën e punes ne menyre efektive per realizimin e detyrave te tyre zyrtare. Kjo kohe nuk perdoret per asnje qellim tjeter, perveçse ne rastet kur perdorimi i saj per qellime te tjera eshte i autorizuar zyrtarisht ne perputhje me ligjet dhe rregullat ne fuqi.

Nepunesi i Bashkise nuk kerkon, inkurajon apo lejon qe vartesis e tij te perdorin kohene punes per te kryer veprimtari te tjera, perveç atyre qe kerkon detyra e ketyre vartesve, apo atyre per te cilat ka nje autprizim siaps ligjeve dhe rregullave ne fuqi.

Neni 28
Ndalimi i shperdorimit te postit

Asnje nepunes i Bashkise apo nje i emeruar qe pret konfirmimin nga zyra e Burimeve Njerezore ne Bashki, nuk duhet te perdore pozicionin aktual apo ate qe pritet te arrije ne te ardhmen,

ne asnje lloj menyre direkte apo indirekte, çfardo personi te jape, ne menyre direkte apo indirekte, çfardo gjeje me vlere e cila kalon per perfitim privat, te zyrtarit pëublik apo nje personi tjetër.

Neni 29

Rastet e shpërdorimit te postit

Nepunesi nuk ka te drejte qe:

- a. te perdore postin e tij per perfitime private, per mbeshtetje e ndonje produkti, shërbimi ose ndermarrje private, per perfitimin privat te miqve ose te afermve te tij.
- b. te perdore apo te lejoje perdorimin e pozicionit, titullit te tij zyrtare, ne nje menyre te tille qe te nxite ose te shtrengoje ndonje person tjetër, perfshire dhe vartesit, per t'i bere ndonje favor financiar ose te ndonje lloji tjetër, atij ose miqve dhe te afermve te tij apo pesonave me te cilet nepunesi eshte i lidhur jo si zyrtar.
- c. te perdore apo te lejoje perdorimin e pozicionit, titullit te tij zyrtar, ne nje menyre te tille qe te lere te kuptohet se bashkia mbeshtet veprimtarine e tij private ose veprimtarine private te ndonje tjetri, me perjashtim te rasteve kur nepunesi eshte i autorizuar te beje nje gje te tille per veprimtarine e te tjereve. Nepunesit i lejohet te firmose letra rekomandimi, duke perdorur titullin e tij zyrtar, per njerez te cilet ai i ka njohur personalisht, kur kjo gje i kerkohet si njerekomandim per punesim.
- d. te perdore postin e tij zyrtar per te penguar veprimtarine e te treteve, ose per t'i demtuar ata per arsye personale
- e. te mos beje asnje veprim i cili, sipas njohurive te tij, mund te krijojë pershtypjen e ky punonjes po shfrytëzon postin per perfitime private te tij ose te miqve a te afermve te tij.

Neni 30

Raste perjashtimore

Nepunesi nuk duhet te perdore paisjet e bashkise per qellime personale, me perjashtim te rasteve kur ai nje gje te tille e ben jashte orarit te punes, pa perdorur materialet e konsumit te Bashkise si dhe duke mos penguar Bashkine nga kryerja e puneve te saj.

Neni 31

Perjashtimi nga kryerja e aktivitetëve elektorale

Asnje nepunes i Bashkise nuk duhet te perfshihet ne aktivite qe kane te bejne me fushta elektorale, si sigurim fondesh, hartim i materialeve te shkruara apo elektronike, a po kerkime, per nje fushate te çdo pozicioni te zgjedhur apo ne numerim votash:

- a. gjate orarit kur ai/ajo paguhen per te bere pune bashkiake, apo
- b. duke perdorur lehtesirat, paisjet, mjetet apo burimet e Bashkise.

Neni 32

Moslejimi i punesimit te jashtem

Asnje nepunes i Bashkise nuk duhet te perfshihet ne punesim te jashtem gjate orarit qe ai/ajo jane te paguar te bejne pune bashkiake, me perjashtim te rasteve te parashikuara ne ligj.

Neni 33

Ndalimi i shtyrjes dhe inkurajimit per perfshirjen ne aktivitet te ndaluar

Asnje nepunes nuk duhet te detyroje, inkurajoje apo te perpiqet te ndikoje apo inkurajoje ndonje person tjetër te perfshihet ne ndonje aktivitet te ndaluar ne nenet 31 dhe 32.

KREU VI
DHURATAT DHE MITMARRJA

Neni 36
Rastet e ndalimit te dhuratave

Eshte e ndaluar qe nje epunonjes te kerkoje ose te marre ne menyre direkte ose indirekte dhurata qe i jepen per shkak te pozicionit te tij zyrtar.

Nje dhurate konsiderohet e dhene per shkak te pozicinit zyrtar te nepunesit, nese kuptohet qarte qe ajo dhurate nuk do te ishte dhene sikur nepunesi te mos ishte ne ate pozicion zyrtar.

Nepunesi ka te drejte qe:

- a. ne menyre direkte ose indirekte, te jape dhurata ose te kontriboje per te dhene dhurata dhe as te kerkoje nga te tjeret dhurata ose kontribute per dhurata per nje nepunes te nje niveli me te larte;
- b. ne menyre direkte ose indirekte, te kerkoje ose te pranoje dhurata nga nepunes te nje niveli me te ulet.

Neni 37
Rastet e mitmarrjes

Eshte e ndaluar qe:

- a. nje nepunes ose ish nepunes Bashkiak te pranoje nga cilido qofte qe, ne menyre direkte ose indirekte, ti jape, ofroje ose premtojte para ose çdo gje me vlere monetare per ndonje veprim zyrtar te kruer prej tij;
- b. nje nepunes ose ish-nepunes Bashkiak te kerkoje te marre nga cilido qofte, ne menyre direkte ose indirekte, para ose çdo gje tjeter me vlere monetare, per veten e tij, ose per ndonje person tjeter, organizate apo entitet, si shperblim per ndonje veprim zyrtar te kryer prej tij.

KREU VII
MBROJTJA E NEPUNESVE NDAJ NDESHKIMEVE PER SHKAK RAPORTIMIT TE RASTEVE TE SHKELJEVE TE KODIT

Neni 38
Mbrotjtja nga raportimet

Asnje nepunes i Bashkise nuk duhet te perdore apo te kercenoje se do te perdore autoritet zyrtar apo influence per te dekurajuar, kufizuar, apo nderhyre tek ndonje peson tjeter me qellim ndalimin e ketij personi per te vepruar ne menyre te drejte per te raportuar ne zyren e burimeve njerzore çfardo lloj informacioni i cili nese do te ishte i vertet do te konsistonte ne:

- a. nje shkeljeve te ligjeve apo akteve nenligjore nga nje nepunes bashkiak,
- b. abuzim te larte pushteti,
- c. rrezik te specifikuar dhe thelbesor per sigurine dhe shendetin publik per shkak te nje akti apo neglizhence te nje nepunesi Bashkiak,
- d. shperdorimin e detyres apo pozicionit Bashkiak dhe burimeve bashkiake per perfitime private,
- e. konflikt interesash nga nje nepunes i Bashkise.

Neni 39
Ankimi

Çdo person qe beson se eshte bere subjekt i ndonje veprimi te ndaluar nga kapitull, mund te beje nje ankese konfidenciale ne zyren e personelit. Zyra e personelit duhet qe te kryeje verifikimin e kesaj ankese. Pas konkluzioneve te verifikimit ajo duhet te ndermarre veprimet e pershtatshme siç parashikohet nga ligjet ne fuqi.

KREU VIII
MASAT
DISIPLINORE

Neni 40
Llojet e masave disiplinore

Ndaj punonjesve qe shkelin parimet e etikes te percaktuarar ne kete kod, kur veprimet e tyre nuk perbejne veper penale, merren masat disiplinore si me poshte:

- a. Verejtje me shkrim
- b. Verejtje me paralajmerim
- c. Pezullimi nga e drejta e ngritjes ne detyre, per nje periudhe deri ne dy vjet
- d. Kalimi ne nje detyre te nje niveli apo me te ulet per nje periudhe nga 30 dite deri ne nje vit.
- e. Largimi nga puna.

Masat e mesiperme disiplinore mund te shlyhen n.q.s brenda nje viti nga dita e dhenies se tyre per shkronjat a dhe b te ketij neni; dhe brenda tre vjetesh nga dita e dhenies se tyre per shkronjat c dhe d ndaj nepunesit bashkiak nuk eshte marre ndonje mase disiplinore. Masat disiplinore te shlyera hiqen nga dosja vetiake.

Ankesat kunder vendimeve per marrjen e masave disiplinore paraqiten ne Komisionin Konsultativ te Etikes brenda 30 diteve nga komunikimi i tyre.